

URDHËR
Nr. 878, datë 25.6. 2021

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR NËNSHKRIMIN E URDHRAVE PËR
DHËNIE PAGESE PAPUNËSIE PËR BASHKËSHORTEN/IN E USHTARAKUT
AKTIV TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të germës “f”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.6.2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 37, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 17.12.2004, “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë për bashkëshortin/en e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e urdhrave për dhënie dhe ndërprerje të pagesës së papunësisë për bashkëshorten/in e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura, te zëvendësministri i Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 1271, datë 20.8.2018, i ministrit të Mbrojtjes, “Për delegim kompetencash për nënshkrimin e urdhrave për dhënie pagese papunësie për bashkëshorten/in e ushtarakut aktiv të Forcave të Armatosura”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi